BASHKIA
TIRANË

R E P U B L I K A   E   S H Q I P Ë R I S Ë

**BASHKIA E TIRANËS**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE E GJELBËRIMIT**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Nr.      Prot                                                    Tiranë më, 10.05.2022

Drejtuar: **BESNIK MEÇI P.F** me Nipt **L12407012R** Adresa: AUTOSTRADA TR-DR, km 5, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedure e Hapur e THjeshtuar

Numri i procedurës/referenca e Lotit: **REF-24988-04-13-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës“**Blerje VAJ’ (Vajra Lubrifikant për mjete, Alkool Frenash, Antifriz, Adblu, Graso)**”, me fond limit: **: 5 237 660** (pesëmilion e dyqind e tridhjetë e shtatëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë (**pa TVSH).**
Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:15 (pesembëdhjetë) dite nga data e lidhjes së kontratës.
Publikimet e mëparshme: **Ka pasur**
Buletini i Njoftimeve Publike: **Nr. 50 datë 19 Prill 2022**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**
Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertues si më poshtë vijon me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **“B&A-02” SH.A** **K21720007H**

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

**Vlera: 3 334 000** (tremilion e treqind e tidhjete e katermije) **lekë pa TVSH.**

2. **Ideal Dragjoshi P.F** **M02012007R**

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera: **3 300 000** (tremilion e treqind mije) **leke pa TVSH.**

3. **TOP-OIL SH.A** **K16604717F**

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera : **3 541 500** (tre milion e peseqind e dyzet e njemije e peseqind) **lekë pa TVSH.**

4. **SHPRESA-AL shpk** **K31321021N**

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera: **4 990 000** (katermilion e nenteqind e nentedhjetemije) **lekë pa TVSH**

5. **KADIU SH.A** **J61817045K**

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera: **4 728 500** (katermilion e shtateqind e njezet e tetemije e peseqind) **leke pa TVSH.**

6. **Besnik Meçi P.F** **L12407012R**

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera**: 4 551 500** (katermilion e peseqind e pesedhjete e njemije e peseqind) **leke pa TVSH**.

Nga pjesërmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. **"B&A-02" SH.A** **K21720007H**

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

**Vlera: 3 334 000** (tremilion e treqind e tidhjete e katermije) **lekë pa TVSH.**

Klasifikimi u bë për arsyet e mëposhtme:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim
- Nuk i plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST
- Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës rezulton anomalisht e ulët.

Operatori Ekonomik B&A 02, **nuk përmbush** pikën 2.3 'Kapaciteti Teknik', nënpika 2.3.3, dhe gjithahshtu nuk përmbush specifikimet teknike, ku specifikisht:

**a. Për VAJ Motorri 15W-40:**

Sipas Fletë-Analizës paraqitur nga OE B&A 02;

Viskoziteti në 40˚ raporton 86.4 $mm^2/s$, ndërkohë tek specifikimiet teknike të AK është kërkuar të jetë midis kufijve 104-108 CST.

Pika e flakërimit raportohet 220˚C, ndërkohë tek specifikimet teknike të AK, minimumi i pikës së flakërimit është 238˚C.

Aciditeti, ose Total Base Number (TBN) raportohet 7.0 mgKOH/g, ndërkohë tek specifikimet teknike të AK është kërkuar midis kufijve 9-10 mgKOH/g.

Pika e rrjedhjes raportohet - 30˚C, ndërkohë tek specifikimet teknike të AK, pika e rrjedhjes është kërkuar minimumi -33 ˚C.

**b. Për VAJ Diferenciali 75W-90**

Densiteti i Vajit 75W-90 në 15˚, tejkalon normën e vendosur nga AK tek specifikimet teknike, ku përkatësisht raportohet një vlerë prej 0.8843 $g/cm^3$, ndërkohë që nga AK është kërkuar **0.870-0.880 $g/cm^3$.**

Viskoziteti në 40˚, është kërkuar nga AK në normën 100-110 $mm^2/s$, ndërkohë në fletë-analizë është raportuar 97.6 $mm^2/s$.

Viskoziteti në 100˚, është kërkuar nga AK në normën 12-14 $mm^2/s$, ndërkohë në fletë-analizë është raportuar 16.2 $mm^2/s$.

Pika e flakërimit është kërkuar nga AK në specifikime teknike minimumi 240 ˚C, ndërkohë sipas fletë-analizës raportohet 203 ˚C, pra nën vlerën e kërkuar.

**c. Për VAJ Kambio Manuale 80W-90.**

Densiteti i Vajit 80W-90 në 15˚, tejkalon normën e vendosur nga AK tek specifikimet teknike, ku përkatësisht raportohet një vlerë prej 0.8843 g/cm3, ndërkohë që nga AK është kërkuar 0.850-0.870 g/cm3.

Viskoziteti në 40˚, është kërkuar nga AK në normën 80-100 $mm^2/s$, ndërkohë në fletë-analizë është raportuar 165.0 $mm^2/s$.

Viskoziteti në 100˚, është kërkuar nga AK në normën 13.5-18.5 $mm^2/s$, ndërkohë në fletë-analizë është raportuar 16.31 $mm^2/s$.

Indeksi i viskozitetit sipas specifikimeve teknike të AK është kërkuar minimumi 144, ndërkohë në fletë-analizë është raportuar 16.31.

Pika e flakërimit është kërkuar nga AK në specifikime teknike minimumi 225 ˚C, ndërkohë sipas fletë-analizës raportohet 220 ˚C, pra nën vlerën e kërkuar.

Pika e ngrirjes është kërkuar minimumi -34 ˚C, ndërkohë sipas fletë-analizës së paraqitur raportohet -30 ˚C.

**d. Për VAJ Michele 2T**

Densiteti i Vajit Michele 2T në 15˚, tejkalon normën e vendosur nga AK tek specifikimet teknike, ku përkatësisht raportohet një vlerë prej 0.8814 g/cm3, ndërkohë që nga AK është kërkuar 0.850-0.860 g/cm3.

Viskoziteti në 40˚, është kërkuar 80-85 Cst, ndrkoh vlera sipas flet-analizës së paraqitur nga OE B&A-02 raportohet të jetë 142.1 $mm^2/s$.

Indeksi i viskozitetit sipas specifikimeve teknike të AK është kërkuar të jetë mbi 140, ndërkohë në fletë-analizë është raportuar 101.

Aciditeti ose Total Base Number sipas specifikimeve teknike të AK është kërkuar 10-11 mgKOH/g, ndërkohë në fletë-analizë raportohet 1.9 mgKOH/g.

Pika e ngrirjes është kërkuar minimumi -34 ˚C, ndërkohë sipas fletë-analizës së paraqitur raportohet -18 ˚C.

**e. Për VAJ Motorri 20W-50**

Densiteti i Vajit 20W-50 në 15˚, tejkalon normën e vendosur nga AK tek specifikimet teknike, ku përkatësisht raportohet një vlerë prej 0.8691 g/cm3, ndërkohë që nga AK është kërkuar në normën 0.870-0.890 g/cm3.

Viskoziteti në 40˚, është kërkuar 130-135 Cst, ndrkoh vlera sipas flet-analizës së paraqitur nga OE B&A-02 raportohet të jetë 125.0 $mm^2/s$.

Viskoziteti në 100˚, është kërkuar nga AK në normën 14-16 mm2/s, ndërkohë në fletë-analizë është raportuar 16.48 mm2/s.

Pika e flakërimit është kërkuar nga AK në specifikime teknike minimumi 251 ˚C, ndërkohë sipas fletë-analizës raportohet 232 ˚C, pra nën vlerën e kërkuar.

**f. Për VAJ Hidraulik ISO 68**

Densiteti i Vajit 20W-50 në 15˚, tejkalon normën e vendosur nga AK tek specifikimet teknike, ku përkatësisht raportohet një vlerë prej 0.8650 g/cm3, ndërkohë që nga AK është kërkuar në normën 0.870-0.880 g/cm3.

Viskoziteti në 40˚, është kërkuar 107-110 Cst, ndrkohë vlera sipas flet-analizës së paraqitur nga OE B&A-02 raportohet të jetë 125.0 mm2/s.

Viskoziteti në 100˚, është kërkuar nga AK në normën 12-14 mm2/s, ndërkohë në fletë-analizë është raportuar 8.657 mm2/s.

Pika e flakërimit është kërkuar nga AK në specifikime teknike minimumi 240 ˚C, ndërkohë sipas fletë-analizës raportohet 235 ˚C, pra nën vlerën e kërkuar.

Pika e ngrirjes është kërkuar minimumi -25 ˚C, ndërkohë sipas fletë-analizës së paraqitur raportohet -21 ˚C.

**g. Për VAJ Hidraulik 10W-30**

Aciditeti, ose Total Base Number (TBN) raportohet 11.4 mgKOH/g, ndërkohë tek specifikimet teknike të AK është kërkuar midis kufijve 6-8 mgKOH/g.

**h. Për VAJ Hidraulik ISO 46**

Densiteti i VajiT Hidraulik ISO 46 në 15˚, tejkalon normën e vendosur nga AK tek specifikimet teknike, ku përkatësisht raportohet një vlerë prej 0.8597 g/cm3, ndërkohë që nga AK është kërkuar në normën 0.865-0.870 g/cm3.

Viskoziteti në 40˚, është kërkuar 30-40 Cst, ndrkohë vlera sipas flet-analizës së paraqitur nga OE B&A-02 raportohet të jetë 42.11 mm2/s.

Pika e ngrirjes është kërkuar minimumi -31 ˚C, ndërkohë sipas fletë-analizës së paraqitur raportohet -27 ˚C.

**i. Për Vaj Motorri 10W-40**

Viskoziteti në 100˚, është kërkuar nga AK në normën 12-14 mm2/s, ndërkohë në fletë-analizë është raportuar 14.02 mm2/s.

Pika e flakërimit është kërkuar nga AK në specifikime teknike minimumi 230 ˚C, ndërkohë sipas fletë-analizës raportohet 228 ˚C, pra nën vlerën e kërkuar.

- OE B&A-02 SH.A nuk plotëson pikën 2.3.5 të DST pasi në dokumentat e paraqitura për mjetin e marrë me qera nuk figuron siguracioni i mjetit.

- Oferta Ekonomike e subjektit "**B&A-02" sh.a**, rezulton anomialisht e ulët. Bazuar në Nenin 93 'Oferta anomalisht e ulët' të Ligjit Nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik", gjithashtu bazuar në Nenin 82 pika 4. të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 'Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik'. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në rastin konkret , kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Referuar Nenit 93 të Ligjit 162/2020 "Per Prokurimin Publik" , oferta ekonomike e subjektit "**B&A-02" sh.a** rezulton të jetë anomalisht e ulët, i

eshte kërkuar operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

- OE B&A-02 ***nuk ka kthyer përgjigje brënda tri ditësh*** pune siç parashikohet në ligj.

---

**2. Ideal Dragjoshi P.F** **M02012007R**

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera: **3 300 000** (tremilion e treqind mije) **leke pa TVSH.**

Klasifikimi u bë për arsyet e mëposhtme:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim
- Nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST
- Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës rezulton oferte anomalisht e ulet.

a) **OE Ideal Dragjoshi** nuk plotëson pikën 2.2 'Kriteret e Veçanta të Kualifikimit', specifikisht pika 2.2 'Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar', nënpika 2.2.2, pasi nuk ka paraqitur kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve te fundit ushtrimore (2019, 2020, 2021).

b) **OE Ideal Dragjoshi** nuk plotëson pikën 2.3 'Kapaciteti Teknik', nënpika 2.3.1, pasi OE nuk ka paraqitur dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

*c)* **OE Ideal Dragjoshi** nuk plotëson pikën 2.3 'Kapaciteti Teknik', nënpika 2.3.3, pasi nuk ka paraitur fletë analizë për vajin objekt prokurimi të lëshuar nga ISHTI, apo nga laburatorë të çertifikuar ndërkombëtar.

d) **OE Ideal Dragjoshi** nuk plotëson pikën 2.3 'Kapaciteti Teknik', nënpika 2.3.5, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm për mjetin e kërkuar në pikën 2.3.5, dhe as nuk e ka deklaruar mjetin në formularin e vetë-deklarimit.

e) **OE Ideal Dragjoshi** nuk plotëson pikën 2.3 'Kapaciteti Teknik', nënpika 2.3.6, pasi çertifikata ISO 9001 :2015 e uploduar në sistem nuk është në emër të tij, por të një tjetër OE.

f) **OE Ideal Dragjoshi** nuk ka paraqitur fletë-analiza për mallin e kërkuar të cilat të vërtetojnë përmbushjen e specifikimeve teknike.

g) Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës rezulton se oferta ekonomike eshte anomalisht e ulet bazuar ne formulen e percaktuar ne DST dhe perllogaritjes se bazuar në Nenin 82 pika 4. të VKM Nr. 285 date 19.05.2021 'Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik',i eshte kërkuar shpjegim nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik të APP, ne

llogarine e tij duke u bazuar në Nenin 93 ‘Oferta anomalisht e ulët’ të Ligjit Nr. 162/2020 ‘Për Prokurimin Publik’.

---

**3. TOP-OIL SH.A** **K16604717F**

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera : **3 541 500** (tre milion e peseqind e dyzet e njemije e peseqind) **lekë pa TVSH.**

Klasifikimi u bë për arsyet e mëposhtme:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim
- I plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST
- Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës nuk ka ofertë ekonomike.anomalisht te ulët.

**Operatori Ekonomik «TOP-OIL sh.p.k është tërhequr nga oferta ekonomike, pasi më datë 09.05.2022 ka dërguar ‘Njoftim për tërheqje’, në sistemin e prokurimit elektronik të APP**.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë : **Besnik Meçi P.F me** NIPT: **L12407012R** me Adresë: AUTOSTRADA TR-DR, km 5, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: **4 551 500** (katermilion e peseqind e pesedhjete e njemije e peseqind) **leke pa TVSH** dhe vlera totale: **5 461 800** (pesemilion e katerqind e gjashtedhjete e njemije e teteqind) **lekë me TVSH** është identifikuar si Oferta më e suksesshme e bazuar në çmim.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Arlinda Binjaku**